



**"AlbAudit" SH.P.K.**

**Lidhja Demokratike e Kosovës  
(LDK)**

**Raporti i Auditorit të Pavarur**

**Pasqyrat Financiare**

**31 Dhjetor 2022**

**Tetor 2023**

## **P ë r m b a j t j a**

Raporti i Auditorit të Pavarur.....	3
Informata të Përgjithshme mbi Subjektin Politik.....	5
Pasqyrat Financiare.....	6
Shpalosjet e Pasqyrave Financiare.....	8
Përfundimi.....	12



“AlbAudit” SH.P.K.

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

**Për: Drejtimit të “Lidhja Demokratike e Kosovës” – Prishtinë**

### Opinionin i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të SP (Subjektit Politik) “**Lidhja Demokratike e Kosovës**” (më tutje referuar si “Subjekt Politik” ose LDK), që përfshinë Pasqyrën e Pozitës Financiare më 31 Dhjetor 2022 dhe Pasqyra e Të Hyrave dhe Shpenzimeve, si dhe një përmbledhje të Politikave të Kontabilitetit dhe Shënimeve Shpjeguese të Pasqyrave Financiare.

- Sipas opinionit tonë, përvës efekteve të përshkruara në paragrafin e Bazës për opinionin të kualifikuar, Pasqyrat Financiare shoqëruese të Subjektit Politik – Lidhja Demokratike e Kosovës, paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale të Pasqyrës së Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2022 dhe Pasqyra e Të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar në këtë datë, si dhe Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare, ne pajtim me ligjin Nr. 03/L-174 Mbi Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe Plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058 dhe ligjin Nr. 04/L-212 si dhe ligjin Nr. 08/L-122.

### Baza për Opinionin të Kualifikuar:

- Siç është raportuar në shënimin 8 Llogaritë e pagueshme dhe tjera, në vlerë prej 466,397.14 EUR (31 Dhjetor 2021: 572,811.35 euro), prej të cilës shuma prej; 75,821.92 Euro, që llogariten të vjetëra janë Llogari të pagueshme ku në mungesë të konfirmimeve dhe dokumenteve relevante mbështetëse, duke përdor procedurat standard dhe alternative të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të bindemi lidhur me saktësin, plotësin dhe ekzistencë e tyre në datën e raportimit.
- Gjatë auditimit tonë ne kemi konstatuar që subjekti politik LDK për zyret e selisë qendrore – Prishtinë, nuk ka arritur të pezantoj kontratën e blerjes, apo dokument tjetër relevant, për të deshmuar deklarinimin e tyre se objekti në fjalë është pronë e SP LDK.
- Duke përdorur testet alternative të auditimit, mund të vlerësojmë se SP – LDK ka raportuar shpenzimet e qiras të nënvlersuar në pasqyra financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë. Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga Subjekti Politik dhe shoqëria në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështjet Kryesore të Auditimit - Theksim i Çështjes

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori



**“AlbAudit” SH.P.K.**

konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne terheqim vemendjen lidhur me momentet e mëposhtme:

- Subjekti Politik përveç llogari bankare aktive në NLB Prishtina, posedon llogari bankare në Bankën Ekonomike – Gjakovë, ndonse gjatë vitit 2022 nuk ka realizuar ndonjë transaksion nga kjo llogari. Ne kemi hasur në dëshmi të shkruara që SP ka dërguar shkresa zyrtar për mbylljes e saj, mirëpo sipas shkresës së Banka komerciale përkatëse një veprim i tillë nuk ka mund të realizohet mëqë ka urdhresa nga Gjykata Komunale në Gjakovë.

### **Përgjegjësia e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjin Nr. 04/L-174 Mbi Financimin e Partive Politike, i Ndryshuar dhe Plotesuar me ligjin Nr. 04/L-058 dhe ligjin Nr. 04/L-212 si dhe ligjin Nr. 08/L-122. Për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të gabimit apo mashtrimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësitë e subjektit politik për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se kur drejtimi synon ta likuioj subjektin politik ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër. Të ngarkuarit me qeverisjen e Subjektit Politik, janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP.

### **Përgjegjësia e audituesit të pavarur**

Objektivat tona gjatë auditimit janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshinë opinion tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoj gjithmonë një anomali materiale kur ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose se bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

**“AlbAudit” SH.P.K.**

**Hajdar Hoxhaj, Auditor Ligjor**

**16 tetor 2023**

## 1. Informata të Përgjithshme mbi Subjektin Politik

Emri i plotë i Subjektit Politik, është “**Lidhja Demokratike e Kosovës**” LDK, regjistruar më 21/08/2000, më selin qendrorë në Qafa, Rr.U.Ç.K. Prishtinë.

Kryetari i SP për vitin raportues (2022) është zt. Lumir Abdixhiku.

Përfaqësuesi Financiar i SP është zt. Mustaf Krasniqi.

Pasqyrat Financiare të SP janë përgaditur dhe prezantuar në pajtueshmëri me ligjin Nr. 04/L-174 Mbi Financimin e Partive Politike, i Ndryshuar dhe Plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058 dhe ligjin Nr. 04/L-212 si dhe ligjin Nr. 08/L-122.

Bazua në ligjin Nr. 08/L-122 Për Plotësim dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-212, nenin 19, paragrafi 7 - Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve paraprake të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga auditorët.

Subjekti Politik posedon llogari bankare në NLB Prishtina. Po ashtu SP posedon llogari bankare “Lidhja Demokratike e Kosovës” – Gjakovë, ndonse gjatë vitit 2022 nuk ka realizuar ndonjë transaksion nga kjo llogari. SP ka dërguar shkresa zyrtar për mbylljes e saj, mirëpo Banka komerciale përkatëse nuk ka realizuar ndonjë veprim të till deri tani.

## 2. Pasqyrat Financiare

Pasqyra e Pozitës Financiare Me 31 Dhjetor 2022			Akronimi: _____	
P	Pasuritë	Shënimi	31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro	31 dhjetor 2021 Shuma në Euro
P.1	<b>Pasuritë afatgjata</b>			
P.1.1	Toka, objektet dhe pajisjet	5	36,781.34	7,916.67
P.1.2	Pasuritë e paprekshme			
P.1.3	Pasuritë tjera afatgjata			
	<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>36,781.34</b>	<b>7,916.67</b>
P.2	<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
P.2.1	Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	
P.2.2	Parapagimet			
P.2.3	Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	708.98	1,845.82
P.2.4	Pasuritë tjera afatshkurtra			
	<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>708.98</b>	<b>1,845.82</b>
	<b>Gjithsej pasuritë (P.1+P.2)</b>		<b>37,490.32</b>	<b>9,762.49</b>
E	<b>Ekuiteti</b>			
E.1	Fondet e akumuluar		(630,152.77)	(27,972.69)
E.2	Suficiti / (deficiti) i vitit		66,282.19	(602,180.08)
	<b>Gjithsej Ekuiteti</b>		<b>(563,870.58)</b>	<b>(630,152.77)</b>
D	<b>Detyrimet</b>			
D.1	<b>Detyrimet afatgjata</b>			
D.1.1	Huatë e pagueshme		32,986.36	
D.1.2	Të hyrat e shtyera		36,781.34	7,916.67
	<b>Gjithsej detyrimet agatgjata</b>		<b>69,767.70</b>	<b>7,916.67</b>
D.2	<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
D.2.1	Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	466,397.14	572,811.35
D.2.2	Huatë e pagueshme		0.00	
D.2.3	Detyrimet tjera afatshkurtra	9	65,196.06	59,187.24
	<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>531,593.20</b>	<b>631,998.59</b>
	<b>Gjithsej detyrimet (D.1+D.2)</b>		<b>601,360.90</b>	<b>639,915.26</b>
	<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet (E+D)</b>		<b>37,490.32</b>	<b>9,762.49</b>

<b>Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve</b>		Akronimi: _____		
<b>Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2022</b>		<b>Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2021</b>		
		Shënimi	2022	2021
<b>H</b>	<b>Të hyrat</b>			
H.1	Të hyrat nga buxheti		<b>487,140.00</b>	529,006.61
H.2	Të hyrat nga anëtarësia			
H.3	Donacionet dhe kontributet në të holla	3	<b>1,000.00</b>	
H.4	Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
H.5	Të hyrat e fushatës			51,200.82
H.6	Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5	<b>9,195.33</b>	633.83
H.7	Të hyrat tjera		<b>78.68</b>	78.68
	<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>497,414.01</b>	<b>580,919.94</b>
<b>SH</b>	<b>Shpenzimet</b>			
SH.1	Pagat dhe kompenzimet	2	280,288.53	257,876.32
SH.2	Shpenzimet e transportit	2	24,442.52	18,763.50
SH.3	Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	31,828.31	22,968.97
SH.4	Shpenzimet e fushatës	2	0.00	751,694.99
SH.5	Blerja e mallrave	2	3,844.37	17,995.72
SH.6	Shpenzimet e përgjithshme	2	75,046.38	66,932.41
SH.7	Shpenzimet e ndryshme	2	15,681.71	46,868.11
	<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>431,131.82</b>	<b>1,183,100.02</b>
<b>Suficiti (+) ose deficit (-) për vitin (H-SH)</b>			<b>66,282.19</b>	<b>(602,180.08)</b>

### 3. Shpalosjet e Pasqyrave Financiare

#### Shënimi 2. Shpenzimet

Akronimi: \_\_\_\_\_

SH	Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
<b>SH.1</b>	<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
	Pagat dhe kompensimet, neto	242,399.67	223,780.81	18,618.86
	Kontributet pensionale të punëmarrësit	12,793.24	10,824.04	1,969.20
	Kontributet pensionale të punëdhënësit	12,793.24	10,824.04	1,969.20
	Tatimet në të ardhura personale	12,302.38	10,475.90	1,826.48
	Beneficionet tjera			-
	<b>Gjithsej</b>	<b>280,288.53</b>	<b>255,904.79</b>	<b>24,383.74</b>
<b>SH.2</b>	<b>Shpenzimet e transportit</b>			
	Automjetet motorike të huazuara	2,700.00	2,700.00	-
	Karburantet	10,061.70	5,126.98	4,934.72
	Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	8,096.00	6,994.00	1,102.00
	Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave	3,584.82	2,519.92	1,064.90
	Çdo shpenzim tjetër i transportit			-
	<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>24,442.52</b>	<b>17,340.90</b>	<b>7,101.62</b>
<b>SH.3</b>	<b>Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
	Lokali			-
	Ushqimi	27,300.71	6,033.35	21,267.36
	Aktivitete kulturore dhe rekreative			-
	Radio dhe spotet televizive	-	-	-
	Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			-
	Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	4,527.60	1,171.00	3,356.60
	<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>31,828.31</b>	<b>7,204.35</b>	<b>24,623.96</b>
<b>SH.4</b>	<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
	Shpenzimet e fushatës			-
	<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>SH.5</b>	<b>Blerja e mallrave</b>			
	Furnizimi i zyrës	3,367.37	1,295.27	2,072.10
	Pajisjet të vogla	477.00	309.00	168.00
	<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>3,844.37</b>	<b>1,604.27</b>	<b>2,240.10</b>
<b>SH.6</b>	<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
	Qiraja e lokalit të zyrës	58,132.08	19,425.05	38,707.03
	Telefoni, interneti dhe posta	2,390.27	2,390.27	-
	Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	5,328.70	2,035.68	3,293.02



**Subjekti Politik: "Lidhja Demokratike e Kosovës" – Prishtinë**  
**Periudha financiare 01.01.2022 - 31.12.2022**

<b>SH.7</b>	Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	9,195.33		
	Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime			
	<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>75,046.38</b>	<b>23,851.00</b>	<b>42,000.05</b>
	<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
	Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	-	-	-
	Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	15,681.71	11,561.71	4,120.00
	<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>15,681.71</b>	<b>11,561.71</b>	<b>4,120.00</b>
	<b>Gjithsej shpenzimet (nga SH.1 në SH.7)</b>	<b>431,131.82</b>	<b>317,467.02</b>	<b>104,469.47</b>

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Akronimi: \_\_\_\_\_

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Besa Gaxheri	Peje				1,000.00	
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				<b>0.00</b>	<b>1,000.00</b>	<b>0.00</b>

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Akronimi: \_\_\_\_\_

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					<b>0.00</b>

**Shënimi 5. Toka, objektet dhe pajisjet**

Akronimi

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Objektet					<b>0.00</b>
Veturat					<b>0.00</b>
Pajisjet e zyrës	8,550.50		633.83	1,583.33	<b>6,333.34</b>
Pajisjet e teknologjisë informative		38,060.00		7,612.00	<b>30,448.00</b>
Pajisjet tjera					<b>0.00</b>
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>8,550.50</b>	<b>38,060.00</b>	<b>633.83</b>	<b>9,195.33</b>	<b>36,781.34</b>

Shënime tjera

Akronimi: \_\_\_\_\_

Shënimi 6. Llogaritë e arkëtueshme	Me 01 Janar 2022 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
..... blerësi 1		
..... blerësi 2		
..... blerësi 3		
..... blerësi 4		
Llogari të arkëtueshme të tjera		
<b>Gjithsej llogaritë e arkëtueshme</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Paraja në bankë	1,845.82	408.98
Paraja në arkë		300.00
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>1,845.82</b>	<b>708.98</b>

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Shuma në Euro	Shuma në Euro
..... furnitori 1	572,811.35	466,397.14
..... furnitori 2		
..... furnitori 3		
..... furnitori 4		
Llogari të pagueshme të tjera		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>572,811.35</b>	<b>466,397.14</b>

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	18,113.58	24,383.74
Detyrimet për qira	29,480.00	38,707.03
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	11,500.00	
Detyrimet tjera afatshkurtra	93.66	2,105.29
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>59,187.24</b>	<b>65,196.06</b>

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro**

Akronimi: \_\_\_\_\_

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		në euro
Vetue me lising	Kosova Motors JSC	Prishtine			5,074.64
Akomodim dhe Bileta	Airvoyage SHPK	Prishtine	811462762		13,572.00
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro</b>					<b>18,646.64</b>

**4. Përfundim**

Me kompetencë dhe siguri të arsyeshme mund të konstatojmë, nga pasqyrat financiare dhe shpalosjet e pasqyrave, shihet se ekziston një saktësi e mjaftueshme në regjistrime kontabël dhe evidenca. Nuk kemi arritur të vërejmë ndonjë gabim apo tendencë për ndonjë gabim material apo ndonjë mashtrim. Gjatë sigurimit të dokumentacionit nuk kemi hasur në ndonjë pengesë për ta bërë këtë. Auditimin e kemi planifikuar, dhe programin e auditimit e kemi realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ne do të dëshironim të shprehim vlerësimin dhe falënderimin tonë për bashkëpunim dhe asistencë të ofruar nga personeli i kontaktuar i Subjektiut Politik.